


Botim i posaçëm

Dhjetor 2005

TRIBUNA SINDIKALE

**Mbi angazhimin e sindikatave të arsimit
për eliminimin e punës së fëmijëve**



Editorial

ANGAZHIM AKTIV I SINDIKATAVE TE ARSIMIT
PER ELIMINIMIN E PUNES SE FEMIJEVE

Sot eshte nje realitet shume i prekshem qe sindikatat e arsimit ne Shqiperi, FSASH dhe SPASH, krahas veprimtarise per nbrojtjen social ekonomike te anetareve qe perfaqesojne dhe te te gjitha mesuesve, jane pershire aktivisht edhe ne nje veprimtari tjetere te fushes se arsimit, qe lidhet drejtperdrejt me pergatitjen e brezave te ardhshem qe do te marrin mbi vete pergjegjesine e fateve te vendit. Kjo veprimtari eshte puna me femijete. Eshte fjala per ate kategori nrenesish qe i perkasin moshes se detyrimit shkollor por qe nuk e frekuentojne me deshire shkollen, qe per arsye e shkaqe te shumta, kryesisht ekonomike, por edhe shkaqe te tjera familjare e shoqerore, vijojne me hope, me rnderprerje dhe shpesh shtojne radhet e atyre qe e braktisin fare shkollen.

Ne shkalle vendi numri i nrenesve qe braktisin shkollen eshte rreth 8.000. Ky numer eshte i ndryshem per rrethe e zona te ndryshme. Ka rrethe sic eshte periferia e Tiranës, disa komuna te Fierit, Elbasanit, Shkodres, Korces, Vlores apo Durresit, ku numri i nrenesve qe braktisin shkollen eshte shqetsues.

Pikerisht gjendja shqetsuese ne keto rrethe dhe pasojat qe sjell kjo braktisje, sic jane puna e femijete ne muge dhe dari te trafikimi i tyre, i rikthen sindikatat e arsimit qe te angazhohen, krahas aktoreve te tjere te shurte shtetzore dhe te shoqerise civile, ne punen kunder nbrojtjen e femijete dhe ne luften kunder formave te ndaluara antiligjore te tyre.

Ky angazhim nuk eshte thjeshte nje deshire subjektive e tyre dhe aq me shume nuk ka ndodhur rastesisht. Perkundrazi, ato e kane kuptuar se nuk mund te kete modernizim te shkolles, mritje te cilesise se arsimit publik, vazhdim te te mesuarit gjate gjithnje jetes, nese ekzitojne me mijera femije qe braktisin shkollen, qe shtojne radhet e analfabeteve dhe te qytetareve qe i sjellin probleme shoqerise dhe progresit te saj.

Mesuesi, pra edhe anetari i sindikates, nuk mund te qendroje indiferent ndaj ketij fenomeni. Puna e cdo mesuesi me kete kategori femijesh perben nje detyre funksionale te tyre. Askush me mire se mesuesit nuk mund t'i evidentojne keto probleme dhe shqetsime, askush me mire se mesuesit nuk mund t'u qendroje afer ketyre femijete, te njohje problemet dhe shqetsimet e tyre e t'i ndihmoje ata.

Prandaj FSASH dhe SPASH prej me shume se kater vjetesh jane perfshire ne punen me femijet, ne nje veprimtari praktike dhe duke e konsideruar kete si nje detyre funksionale te sindikates.

Cfar kemi bere ne per kete ?

Se pari, ne bashkepunim dhe me ndihmen e ILO - IPEC e kemi filluar me pergatitjen e nje grupi sindikalistesh te trainuar per problemin e punes se femijete. Sot FSASH dhe SPASH kane nje kontingjent mesuesish sindikaliste qe njohin mire kuadrin ligjor kombetar dhe konventat rnderkombetare qe trajtojne problemin e punes se femijete. Keta trainues jane te afte te zhvillojne ne zona dhe shkolla te vecanta seminare me mesues te tjere ne menyre te pavanur dhe me cilesi. Nepermjet ketyre seminarave arrihet te sensibilizohet qinioni i gjithje i mesuesve per kete fenomen dhe arrihet qe te shtohet numri i mesuesve qe angazhohen ne punen per minimizimin dhe eliminimin e fenomenit.

Se dyti, sindikatat e arsimit, mbasi kane evidentuar dhe percaktuar zonat me probleme per punen e femijete, kane zhvilluar dhe vazhdojne te zhvillojne programe konkrete per pergatitjen e mesuesve, vecanerisht te atyre te ciklit te ulet te shkolles 9 - vjecare me pjessmarzjen e dhjetra dhe qindra mesuesve, duke i pergatitur ata dhe perfshire efektivistit ne punen per nbrojtjen e femijete. Programe te tilla ato kane me Sindikaten Holadeze te Arsimit, AOB, me ILO-PEC, etj.

Se treti, sindikatat e arsimit kane mitur veprimtarine informuese dhe propagandistike per punen e femijete me botime te shumta ne forme pembledhjesh, pamfletesh e sidomos

Nepermjet Revistes "Tribuna Sindikale".

Se katerti, sindikatat e arsimit kane rndermarre nismen qe te shperbejne si bosht rbeshtetes per te perfshire ne kete veprimtari edhe sindikatat e profesioneve te tjera, si ato te bujqesise, shpatsise, tekstil-artizanatit, transportit, etj.

Objektivi kryesor qe synojne te arrijne eshte qe veprimtaria jone te behet e natshme, konkrete dhe efektive, me qellim qe nga periudha ne periudhe, nga programi ne program, numri i femijete qe braktisin shkollen dhe i femijete qe punojne te vijne duke u zvogeluar dhe te shtojne drejt eliminimit progresiv.

Xhafer DOBRUSHI

PERMBAJTJA

- ✓ Editorial: Angazhim aktiv i sindikatave te arsimit per eliminimin e punes se femijete 2
- ✓ Pse puna e femijete eshte nje ceshtje sindikale 3
- ✓ Eliminimi i punes se femijete ceshtje e rrendesishme per sindikatat e arsimit, (Nga zbatimi i Programit te FSASH me IPEC) 3
- ✓ Nje liber shume i vlefshem jo vetem per sindikatat e arsimit 4
- ✓ Trajnime dhe plane veprimi konkrete per parandalimin e punes se femijete (Nga seminare e organizuara me ILO-IPEC ne Korçe e Berat) 6
- ✓ Veprime konkrete dhe bashkepunim i gjere per eliminimin e punes se femijete (Nga Seminari i zhvilluar ne rrethin e Elbasanit, ne kuadrin e Projektit me AOB) 8
- ✓ Tre prononcime te Kryetareve te Grupeve te Punes ne Fier, Elbasan e Tirane per angazhimin e sindikatave te arsimit ne luften kunder punes se femijete 9
- ✓ Aktivitete efektive te IPEC ne Shqiperi 14
- ✓ Metoda SCREAM ne seminare me perfaqesuesit e sindikatave te arsimit ne rrethe 15

Kopertina e pare:

Kopertina e Librit "Sindikatat dhe Puna e Femijete", botuar nga FSASH per sindikatat shqiptare dhe ato te Kosoves

Kopertina e fundit:

Pamje nga Seminari zhvilluar ne Elbasan mbi eliminimin e punes se femijete

TRIBUNA SINDIKALE

Numër i posaçëm

Mbi angazhimin e sindikatave te arsimit per eliminimin e punes se femijete
Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare"
Pallati Ali Kelmendi, kati III,
Tel: 22 83 46; Tel & Fax: 25 65 32
Keshilli Botues:

Xhafer Dobrushii,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

Pse puna e fëmijëve është një çështje sindikale?

Shumë nga ata që janë të përfshirë në çështjen e eliminimit të punës së fëmijëve argumentojnë se puna e fëmijëve është një problem që duhet ta zgjidhë qeveria. Në fakt, puna e fëmijëve ka kaç shumë aspekte dhe arsye të ekzistencës së saj janë kaç komplekse, sa nuk mund të presim që këtë çështje ta zgjidhë vetëm qeveria. Problemi do të mund të zgjidhet vetëm me angazhimin dhe përpjekjet e një numri të madh partnerësh, duke përfshirë edhe sindikatat.

Organizatat e punëtorëve janë institucione logjike që paraprijnë në zbulimin dhe denoncimin e punës së fëmijëve në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar. Ato mund të bëhen avokate të vlefshme për mbrojtjen e fëmijëve, kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve në vendin e punës, duke dokumentuar rastet konkrete të punës së fëmijëve dhe efektet e saj tek të miturit. Sindikatat mund të duhet të kërkojnë të drejtën e punonjësve për pagesë të përshtatshme dhe, në këtë mënyrë, të ulin numrin e familjeve të varfëra, që varen nga puna e fëmijëve.

Organizatat e punëtorëve kanë mundësi komunikimi me një numër të madh punëtorësh të mitur dhe familjet e tyre. Ato mund të trajtojnë rëndësinë e përkrahjes së arsimimit të fëmijëve të tyre, të mbrojnë fëmijët nga rreziqet e punës dhe nga punësimi në moshë shumë të re. Si një grup

presioni potencialisht i fuqishëm, sindikatat duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në bisedimet për kontratat



Në njerën nga seancat e seminarit në Shkollën "Dino Ismaili" në Levan të Fierit

kollektive dhe në përpjekjet për të mobilizuar shoqërinë në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Por le të shohim më nga afër disa nga arsye të pse puna e fëmijëve është një çështje që u përket sindikatave:

Puna e fëmijëve favorizon sektorin informal

Kudo në botë e veçanërisht në vendet në zhvillim, sektori i paorganizuar ose informal, po rritet dita ditës. Për sindikatat, ky sektor është veçanërisht i vështirë për t'u organizuar. Pikërisht këtu ekziston më shumë puna e fëmijëve. Prandaj, nëse marrim përsipër këtë çështje dhe angazhohemi në këtë problem, ne mund të mësojmë më shumë për sektorin informal dhe mund të jemi më të suksesshëm në zgjidhjen e problemit. Detyrimisht, sindikatat duhet të organizohen në sektorin informal, nëse dëshirojnë të

najnë forcën e tyre numerike.

Puna e fëmijëve minon forcën negociuese të sindikatave

Fëmijët që punojnë përfaqësojnë një burim të pasur të punës me kosto të ulët. Kjo kontribuon në uljen e pagave dhe çon në dobësimin e aftësive të sindikatave për të negociuar mbi përmirësimin e pagave e të kushteve të punës.

Puna e fëmijëve kontribuon në papunësinë e të rriturve

Me një pagë shumë më të ulët, një fëmijë mund të jetë duke punuar në një sektor ku mund të punonte një i rritur. Në rast se fëmijët largohen e rriafëtsohen, puna mund të kërket nga një i rritur. Ka shumë raste, kur prindërit janë të papunë, ndërsa fëmijët punojnë. Kjo është një gjë e keqe për të dy. Është e kundërta e asaj që realisht duhet të ndodhë.

Prandaj sindikatat thonë:

Fëmijët jashtë punës dhe në shkollë; të rriturit në punë!

Arsyeja ekonomike-Varfëria kudo, është një kërcënim për përparimin në çdo vend

Varfëria është, pa dyshim, një ndër shkaqet kryesore që ndikon në punën e fëmijëve. Por, nga ara tjetër, vetë puna e fëmijëve është një ndër shkaqet e varfërisë. Nëse fëmijët kryejnë punën e të rriturve, kundrejt një page më të ultë, atëherë ky është një kërcënim ndaj pagave e kushteve të punës të të rriturve. Sindikatat janë në pozicionin e duhur për të mbrojtur fëmijët që punojnë, për të përkrahur të drejtën e tyre për t'u shkolluar, ndërkohë që kërkojnë njohjen e së drejtës së të rriturve për paga më të mira.

Solidariteti dhe drejtësia

Bazat e vërteta të sindikatave janë parimet e solidaritetit e drejtësisë. Sindikatat janë krijuar për t'u dhënë punëtorëve një forcë kolektive për të luftuar padrejtësitë, për të penguar shfrytëzimet dhe për të kërkuar kushte të drejta punësimi. Pra, së pari, duhet të ketë një konsensus të gjerë midis punëtorëve, në lidhje me atë që është e drejtë dhe e ndershme. Së dyti, duhet të ekzistojë i njëjti konsensus në shoqëri, nëse dëshirojnë që arditjet të jenë të sigurta dhe jo vetëm të përkrahshme. Prandaj është në interesin e sindikatave të ndihmojnë për krijimin e klinës sociale, e cila do të kontribuojë në eliminimin e punës së fëmijëve.

Eliminimi i punës së fëmijëve, çështje e rëndësishme për sindikatat e arsimit

Nga zbatimi i Programit të FSASH me IPEC

Në vazhdim të angazhimeve të saj për rritjen e rolit të mesuesve, anetareve dhe drejtuesve sindikaliste për luftën kundër punës së fëmijëve, FSASH, në bashkëpunim me Zyren ILO-IPEC në Tiranë, po zbaton një program veprimi mbi rritjen e

kapaciteteve të sindikates shqiptare të arsimit, FSASH, në luftën kundër punës së fëmijëve. Programi po të zbatohet për një periudhë pesë mujore dhe përfshin disa aktivitete të cilat pritet që të kenë një ndikim të drejtëpërdrejtë, jo vetëm tek

drejtuesit dhe aktivistët e sindikatave të arsimit, por edhe tek ata të degëve të tjera.

Programi përfshin perkthimin, pershtatjen dhe botimin në shqip të një libri me përmbajtje shumë interesante të titulluar "Sindikatat dhe Puna e Fëmijëve". Libri

perbehet nga shtate broshura, të cilat trajtojnë çështje të veçanta që kanë të bëjnë me angazhimin e sindikatave për eliminimin e punës së fëmijëve, sic janë politikat sindikale dhe planet e veprimi për të luftuar punën e fëmijëve, gjetja e fakteve dhe informacioni mbi

Vijon në faqen 4

Një Liber shumë i vlefshëm jo vetëm për sindikatat e arsimit

Nga Tryeza e Rrumbullaket për Librin "Sindikatat dhe Puna e Fëmijëve"

Ne kuadrin e programit që FSASH është duke zbatuar, në bashkëpunim me Zyren e ILO-IPEC në Tiranë, këtu dëto u botua Libri "Sindikatat dhe Puna e Fëmijëve", i cili është një instrument shumë i rëndësishëm në duart e drejtuesve sindikaliste dhe mesuesve në përgjithësi, në lidhje me eliminimin e punës së fëmijëve në vendin tonë.

Perkthimi, pershtatja dhe botimi në gjuhën shqipe, në një liber të vetëm, i shtate broshurave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ILO, në tërë qendrën sindikatat kundër punës së fëmijëve nuk është një veprim i vetëm dhe as i shpëputur nga veprimtaria e sindikatave të arsimit në Shqipëri, FSASH e SPASH, si edhe sindikatave të profesioneve të tjera, anëtare të KSSH-se dhe BSPSH-se.

Botimi i këtij Libri, në materialet e pasura që pëmban secila prej broshurave, në përfshirjen e përvojës, ndonëse akoma modeste, të të gjithë faktorëve shqiptarë e posaçërisht të sindikatave, për para-ndalimin e punës së fëmijëve, përben një mbështetje të fortë dhe inkurajim për të gjitha sindikatat, e posaçërisht për ato të arsimit, për t'u përfshirë me me qartësi, përgjegjësi e vendosmëri në procesin e parandalimit dhe eliminimit të punës së fëmijëve, për të hartuar politika dhe plane veprimi efikase, për të siguruar vijuesi e cilësi me të lartë krahasuar në punën e bërë deri tani.

Botimi i këtij Libri është me vlera të shumtë, sepse ai do të përdoret nga drejtuesit dhe aktivistët sindikale, jo vetëm në aktivitetet që kanë të bëjnë me punën e

fëmijëve, por edhe për shumë çështje të tjera të veprimtarisë sindikale.

Kjo gjë u theksua edhe në Tryezën e Rrumbullaket që u organizua në Tiranë, në lidhje me diskutimin e Projektit të këtij Libri, ku morën pjesë drejtues të niveleve të ndryshme të dy sindikatave të arsimit, FSASH e SPASH, të disa Federatave të KSSH të angazhuara në këto probleme, si ajo e Bujqësisë dhe Ushqimit, Shëndetësisë dhe Tekstil Artizanatit, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Punës, specialiste të botimeve, si edhe përfaqësues të disa QJF-ve të angazhuara në problemet e eliminimit të punës së fëmijëve.

Tryeza u drejtua nga Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushit dhe Menaxherja Kombëtare e ILO-IPEC në Tiranë, zonja Snezhi Bedalli.

Pas një prezantimi të të dy drejtuesve të Tryezës, në lidhje me angazhimin e FSASH-it dhe të ILO-IPEC në Tiranë për eliminimin e punës së fëmijëve, Sekretari i Përgjithshëm i FSASH, Stavri Liko, bëri paraqitjen e Librit, duke u ndalur sidomos tek nevojat për këtë liber në shqip, tek shpëgjimi i pëmbajtjes së secilës prej shtatë broshurave që e përbejnë atë dhe tek udhëzimet në lidhje me përdorimin e tij.

Që në fillim, ai theksoi se ka kohë që edhe sindikatat shqiptare kanë filluar të angazhohen për eliminimin e punës së fëmijëve dhe FSASH është në krye të kesaj pune, duke synuar në zgjerimin e angazhimit të saj dhe në përfshirjen e sindikatave të tjera në këtë çështje.

Drejt këtij zgjerimi e angazhimi, sindikatat shqiptare kanë nevojë për udhëzues, por edhe për përvojë e praktika të mira, gjë që plotësohet, në një farë mënyre, me anë të këtij Libri.

Duke u ndalur tek Broshura e Parë, në titull "Udhëzues për Broshurat", ai theksoi se ajo jep udhëzime se si mund të përdoren Broshurat në vijim, në punën dhe jetën e përditshme, në seminarë, në punën studimore, në integrimin e punës së fëmijëve në programet e tjera të sindikatave etj. Ajo ka, gjithashtu, gjashtë shembuj aktivitetesh, si model për seminarët ose aktivitetet të tjera, ka një listë të botimeve në kuadrin e Projekteve të ILO dhe një listë të materialeve që mund të gjenden në zyrat e IPEC.

Broshura e Dytë, në titull "Politikat Sindikale dhe Planet e Veprimit Kundër Punës së Fëmijëve", e

shtite "guri i themelit" për Broshurat që vijojnë. Ajo është baza për shumë aktivitetet që mund të zhvillojnë sindikatat, prandaj duhet të studihet e para, kur mendohet të përdoren Broshurat. Ajo paraqet problemin e punës së fëmijëve aktualisht, paraqet punën e fëmijëve si një çështje sindikale dhe shpëjgon për, shpëjgon procesin e hartimit të politikave sindikale e të planeve të veprimit kundër punës së fëmijëve dhe jep shembuj konkrete të politikave dhe veprimeve sindikale të qendrave sindikale ndërkombëtare si ICFTU, EI, PSI, IUF.

Broshura e Tretë, në titull "Gjetja e Fakteve dhe Informacioni mbi Punën e Fëmijëve" përshkohet nga ideja themelore

Eliminimi i punës së fëmijëve, çështje e rëndësishme për sindikatat e arsimit

Nga zbatimi i Programit të FSASH me IPEC

Vijon nga faqja 3

punën e fëmijëve, organizimi i fushatave kundër punës së fëmijëve, kontratat kolektive dhe përdorimi i standardeve të ILO dhe strukturave tripalëshe për të luftuar punën e fëmijëve etj.

Libri pëmbledh, përvojë nga shumë organizata sindikale ndërkombëtare, jep informacione mbi partnerët sociale, organizatat joqeveritare etj, por ai përfshin, gjithashtu, edhe përvojën dhe problemet me të

cilat përballen sindikatat shqiptare në angazhimin e tyre për eliminimin e punës së fëmijëve.

Përqendrimi në tre rrethë, Korçë, Elbasan dhe Berat, për një punë më konkrete, e ka bërë Programin më efektive dhe krijon me shumë mundësi për të patur rezultate konkrete, sidomos në shmangien e braktisjeve nga shkolla. Seminarët që janë organizuar në Korçë e Berat dhe ai që do të organizohet në Elbasan

paraprihen nga një punë e gjithanëshme përgatitore, përfshirë edhe plotësimin e një pyetësori nga të gjitha pjesëmarrësit mbi gjendjen në shkollat përkatëse dhe do të shpërohen me aktivitetet të tjera, në vijim të këtij programi. Kjo do të ndihmojë edhe për një punë në vazhdimësi, pas përfundimit të programit.

Programi po shpërdoret me një publicitet të gjërë për aktivitetet që po organizohen, nëpërmjet lajmeve në

televizione dhe përgatitjes së emisioneve televizive të posaçme në rrethet ku në jemi të përqendruar. Po kështu edhe ky numer i veçantë i Revistës "Tribuna Sindikale", do të ketë një ndikim të drejtperdrejtë në propagandimin e këtyre aktivitetëve dhe të këtij angazhimi, në funksion të rritjes së efektivitetit të këtyre veprimtarive dhe zgjerimit të tyre edhe në rrethet dhe shkollat e tjera në shkallë vendi.

se veprimet serioze te sindikatave mbi punen e femijeve duhet te bazohen mbi informacione te besueshme dhe sqaron se per çfare informacioni kane nevoje sindikatat, burimet e informacionit, aresyet pse punojne femijet, legjislacioni per punen e femijeve dhe veprimet sindikale qe duhet te ndëmerren. Ajo jep, gjithashtu, udhezime se si mund ta mbledhim informacionin dhe sqaron se çfare mund te bejne sindikatat me informacionin e grumbulluar

Broshura e Katërt, me titull "Fushatat Kunder Punes se Femijeve", pasi ben nje historik te zhvillimit te Fushatave nga sindikatat ne keto 100 vjetet e fundit,



Çast nga Tryeza e Rrumbullaket per diskutimin e Draftit te Librit "Sindikatat dhe Puna e Femijeve"

sqaron se per çfare mund te ndëmerret nje Fushate, jep nivelet e Fushatave, percakton detyrat kryesore qe duhen ndjekur per organizimin e nje Fushate dhe evidenton rendesine e publicitetit per Fushaten.

Broshura e Peste, me titull "Kontratat Kolektive Kunder Punes se Femijeve", ka te beje me Kontratat Kolektive, si mjete tradicional i sindikatave dhe menyra kryesore e tyre per t'u lidhur me punedhënesit. Ajo thekson domosdoshmerine e zgjerimit te pembajtjes se kontratave, jo vetem per pagat, por edhe per sigurine e shëndetit, pensionet,

bashkepunimin me administraten, punen e femijeve etj. Krahas trajtimit te rendesise se kodeve te sjelljes dhe iniciativave te tjera nderkonbetare, ajo sqaron se çfare duhet te perfshihet ne nje marreveshje mbi punen e femijeve.

Broshura e Gjashte, me titull "Përdorimi i Standardeve te ILO per te Luftuar Punen e Femijeve" sqaron se çfare jane standardet nderkonbetare te punes (rregullat qe percaktojne Konventat dhe rekomandimet e ILO), cilat jane standardet

themelore te punes (grupi prej 8 konventash mbi punen e detyruar, shpejblimin e karabarte, mbi te drejten per t'u organizuar, mbi punen e femijeve:konventat 138 e 182 etj. Ajo komenton dhe jep shpjegime te pergjithesme per disa prej tyre, sqaron procedurat e mbikqyrjes dhe ankimeve dhe boton tekstet e plota te Konventave Nr. 138 e 182 dhe te Rekomandimeve perkatese, Nr. 146 dhe 190.

Broshura e Shtate, me titull "Marredheniet Tripaleshe Kunder Punes se Femijeve"

pershkohet nga ideja baze se per te arritur qellimet e tyre, sindikatat duhet te

me pervojen dhe problemet ne vendin tone.

Kryetari i KSSH, zoti Kol Nikollaj, vleresoi botimin e ketij Libri dhe e konsideroi ate si instrument te rendesishem ne duart e sindikalisteve tane. Kryetari i Federates se Bujqesise dhe Ushqimit, zoti Alfred Xhomo, kerkoi qe te planifikohen me shume kopje per sindikatat ne baze, sidomos ne zonat rurale, ku problemi i punes se femijeve eshte me shume i pranishem. Po keshtu, kryetari i Federates se Shëndetësisë, zoti Minella Mano propozoi qe ne Liber te zene me shume vend problemet qe lidhen me trajtimin e femijeve te fshatit dhe sidomos per Broshuren e Dyte te shikohet mundësia per t'u botuar ne sa me shume kopje, sepse eshte shume e rendesishme per drejtuesit dhe aktivistet sindikale.

Zv/Kryetari i SPASH-it, zoti Aleks Dushi, me te drejte, ngriti problemin e perfshirjes me te gjere te qeshtjeve qe lidhen me legjislacionin tone konbetar ne lidhje me parandalimin e punes se femijeve. Edhe aktivistja e SPASH-it, zonja Kozeta Berisha, sugjeroi qe problemi i perfshirjes se punes se femijeve ne negociimet qe pritet te fillojne me Ministrine e Arsimit per Kontraten Kolektive te Punes te mbahen mire parasysh, mbasi deri tani ky mjet i rendesishem i levizjes sindikale nuk eshte perdorur si duhet per kete qeshtje.

Zv/Kryetaret e FSASH-it Fatbardha Keço e Lunturi Mataj, si edhe drejtues te tjere lokale te kesaj Federate, si Osman Nika, Derall Tota etj, kerkuan qe ne Liber te paraqiten me gjere angazhimet e deritanishme te FSASH-it ne lidhje me problemet qe kane te bejne me punen e femijeve.

Menaxherja Konbetare e ILO-IPEC ne Tirane, zonja Snezhi Bedalli vleresoi punen e bere per pergatitjen e Librit, por nderkohe beri disa sugjerime qe kishin te benin sidomos me zgjerimin e informacionit mbi angazhimin e sindikatave shqiptare, bashkepunimin e tyre me ILO-IPEC dhe me Njesine per Punen e Femijeve prane Ministrise se Punes dhe Qeshtjeve Sociale dhe me disa OJF qe jane aktive ne kete drejtim.

Pothuajse te gjithë diskutantët theksuan faktin qe ky Liber eshte shume i vlefshem edhe per faktin se ai mund te perdoret si baze ne aktivitetet trajnuese qe duhet te organizojne sindikatat tona, jo vetem per qeshtjet qe lidhen me pune e femijeve, por edhe per probleme te tjera qe kane te bejne me veprimtarite efektive te sindikatave ne punen e tyre te perditeshme.

bashkepunojne me partneret sociale (punedhënesit, qeverine, (inspektoret e punes), si edhe te krijojne aleanca dhe rrjete, duke siguruar nje bashkepunim te ngushte me ILO-ACTRAV, ILO/EMP dhe ILO-IPEC.

Ne perfundim te prezantimit te vete, zoti Stavri Liko sqaroi se ne Liber jane perfshire edhe kater referenca nga pervoja dhe problemet ne vendin tone, te cilat jane:

Format e punes se femijeve ne Shqiperi (bazuar kryesisht ne raportin e perfagesuesit te ICFTU, S. Gumiau, dhe IPEC, angazhimi dhe aktivitetet e FSASH dhe te KSSH e BSPSH per luften kunder punes se femijeve, legjislacioni shqiptar per luften kunder punes se femijeve, (ratifikimi i konventave, Kushtetuta, Kodi i Punes, VKM), si edhe veprimtaria e IPEC ne Shqiperi, Memorandumi 1999, fushat prioritare, programet kryesore, synimet per te ardhmen.

Ne vijim, u bene diskutime te shumta ne lidhje me pembajtjen e Librit dhe nevojen per disa përmiresime te metejshme, sidomos per qeshtjet qe lidhen

Trajnime dhe plane veprimi konkrete per parandalimin e punes se femijeve

Nga seminarret e organizuara me ILO-IPEC ne Korçe dhe Berat.

Ne vijim te aktiviteteve ne kuadrin e Programit me ILO - IPEC, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, organizoi ne Korçe dhe Berat Seminarret te posaçme per trajnimin e mesuesve sindikaliste qe jane te angazhuar ne parandalimin e punes se femijeve.

Ne Seminarin e Korçes mermin pjese perfaqesues te kesaj Federate nga rrethet Korçe, Devoll e Kolonje, si edhe perfaqesues te Sindikates se Ravatur te Arsimit Shqiptar, SPASH, nga rrethi i Korçes. Ne seminarin e Beratit mermin pjese perfaqesues te FSASH-it nga Berati, Kuçova e Skrapari, si edhe perfaqesues te SPASH-it nga rrethi i Beratit.

Seminarret u paraprine nga nje pune e mire pergatitore, duke organizuar me pare takime ku u shperndane pyetesore ne lidhje me gjendjen dhe angazhimin e sindikatave te arsimit ne shkolla, si edhe te drejtorive te shkollave dhe mesuesve per ceshtjet qe kane te bejne me vijimin e nxenesve ne skolle, me punen e vecante me nxenesit e veshtire ose me nxenesit qe punojne etj.

Te dy Seminarret u drejtuan nga Kryetari i Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, zoti Xhafer Dobrushit dhe Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirane, zonja Snezhi Bedalli.

Ne seminarin e Korçes moren pjese edhe drejtuesit kryesore te keshillave sindikale te dy konfederatave per kete rreth, zoti Nebi Sulejmani, kryetar i Keshillit Sindikal te KSSH dhe zonja Natasha Lubonja kryetare e Keshillit Sindikal te BSPSH.

Ne njerën nga seancat e seminarit te Beratit mori pjese edhe Drejtori i Drejtorise Rajonale te Arsimit, zoti Yzedin Hima.

Tre ishin synimet kryesore te ketyre seminarëve: Trajnimi i mesuesve sindikaliste ne lidhje

me konceptin dhe standardet nderkombetare mbi punen e femijeve, prezantimi i Librit « Sindikatat dhe Puna e Femijeve » dhe analiza e gjendjes ne rrethin e Korçes e te Beratit dhe rrethet fqinje me to, duke pergatitur edhe planet



Pamje nga seminari i zhvilluar me ILO-IPEC ne Korçe

perkatese te veprimit per punen ne te ardhmen.

Ne lidhje me synimin e pare, zonja Snezhi Bedalli punoi me pjesenarresit ne te dy seminarret pothuajse gjate gjithe dites se pare. Ajo foli gjeresisht mbi konceptin mbi punen e femijeve, sqaroi se ku mund te vihet nje vije ndarese midis asaj qe mund te pranohet dhe gjithe formave te punes qe jane te papranueshme per femijet, u ndale hollesisht tek shkaqet e punes se femijeve dhe standardet nderkombetare ne lidhje me te, duke analizuar hollesisht Konventen Nr. 138 mbi moshen minimale te punesimit dhe Konventen nr. 182 mbi format me te keqija te punes se femijeve, si edhe legjislacionin shqiptar ne lidhje me kete ceshtje. Ne vijim, zonja Snezhi Bedalli shpjegoi disa nga Modulet kryesore te Paketes SCREAM, (Mbesh-tetja e te Drejtave te Femijeve Nepermjet Arsimit, Artit dhe Medias), e cila synon te angazhoje me mire mesuesit e te gjitha lendeve ne shkolla per terheqjen e nxenesve ne procesin e arsimit e te

edukimit, nepermjet formave te lamishme e terheqese per ta. Ajo u ndale gjithashtu ne shpjegimin e rendesise se monitorimit te punes se femijeve dhe projekteve qe jane ne zbatim ne vendin tone ne lidhje me kete ceshtje.

Te gjitha shpjegimet qe u bene nga zonja Snezhi Bedalli gjate dites se pare te te dy seminarëve u shoqeruan me nje pjesenarje aktive te mesuesve sindikaliste ne diskutime lidhur me situaten aktuale dhe konceptimin e ketyre problemeve nga ara e tyre, si edhe me ushtrime konkrete, siç ishin ato per njohjen me te mire me njeri - tjetrin ne procesin e punes ne seminare (Globingo) dhe rendesine e njohjen dhe respektimit te te drejtave te femijeve, (Balona me te drejta), te cilat u rekomanduan qe te perdoren gjeresisht nga pjesenarresit ne punen e tyre me nxenesit ose ne seminarret qe ata mund te organizojne me mesues te tjere ne baze shkollash ose rrethesh.

Seminarret vazhduan me prezantimin e Librit « Sindikatat dhe Puna e femijeve », botuar ne kuadrin e ketij programi qe FSASH po zbaton me ILO-IPEC ne Tirane. Sekretari i Pergjithshem i FSASH, Stavri Liko beri shpjegime te hollesishme ne lidhje me Librin, duke u ndalur fillimisht tek puna e Organizates Nderkombetare

te Punes (ILO) dhe Zyres se saj per Aktivitetet e Punetoreve, ACTRAV, ne lidhje me eliminimin e punes se femijeve, tek nevojat qe diktuon botimin e ketij Libri ne shqip, tek vlerat e Librit dhe tek permbajtja e tij. Duke analizuar secilen prej te shtate broshurave qe perbejne Librin, ai u ndale sidomos tek Broshura e Dyte qe trajton hartimin e politikave sindikale dhe te planeve te veprimit per parandalimin e punes se femijeve, tek Broshura e Katert qe trajton orgaizimin e Fushatave kunder punes se femijeve, tek Broshura e Peste qe analizon perdorimin e Kontratave Kolektive per parandalimin e punes se femijeve, si edhe tek Broshura e Shtate qe trajton mardhëniet triparteshme kunder punes se femijeve. Pasi shpjegoi edhe kater referencat ne lidhje me format e punes se femijeve ne vendin tone, pervojën e FSASH e te sindikatave te tjera shqiptare ne lidhje me kete ceshtje, legjislacionin shqiptar mbi punen e femijeve, rolin e ILO-IPEC ne Shqiperi etj, ai u ndale tek vlerat e rendesishme te ketij Libri, jo vetem per mesuesit e per punen e femijeve, por edhe per tere levizjen sindikale ne vendin tone.

Ne seminare u bene diskutime ne lidhje me menyren e perdorimit te ketij Libri dhe u percaktuan detyra konkrete per organizimin e takimeve e te aktivitetëve te tjera per prezantimin e tij, sidomos tek mesuesit sindikaliste, por edhe me gjere.

Nje moment shume efektiv i te dy seminarëve ishte prezantimi i bere nga Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushit ne lidhje me vizionin e kesaj Federate e te sindikatave shqiptare ne pergjithesi ne lidhje me angazhimin per eliminimin e punes se femijeve. Ai u ndale hollesisht tek roli i FSASH-it,

ne bashkepunim me SPASH-in per te siguruar nje angazhim efektive te mesuesve ne shkolla, duke siguruar nje pune konkrete me nxenesit qe braktisin shkollen dhe me ata qe jane ne rrezik per ta braktisur ate per shkak te kushteve ekonomike, por edhe per shkaqe te tjera qe lidhen me mentalitete te gabuara qe ende vihen re, sidomos ne disa zona te thella ose ne periferi et qyteteve te medha nga prinder te ardhur ne keto zona, te cilet i pengojne, sidomos vajzat, qe te kryejne te pakten arsimin e detyrueshem, gje qe krijon premisa per t'i angazhuar ato ne pune. Me tej, duke e konsideruar kete nje faze te re me te larte te aktivitetit te sindikatave te arsimit, zoti Dobrushki theksoi se ato po synojne qe te perfshijne ne kete angazhim edhe sindikatat e sektoreve te tjere ne perberje te KSSH-se dhe BSPSH-se, duke permendur ketu Rezoluten e Kongresit te Thete te KSSH-se, Konferencen Kombetare te organizuar per kete ceshtje nga KSSH e BSPSH, ne bashkepunim me Konfederaten Nderkombetare te Sindikatave te Lira, ICFTU etj.

Ne prezantimin e vete, zoti Dobrushki u ndale edhe tek synimet kryesore te Programit qe eshte duke u zbatuar ne bashkepunim me ILO-IPEC ne Tirane dhe tek Projekti tjetër qe dy sindikatat shqiptare te arsimit jane duke zbatuar ne bashkepunim me sindikaten e arsimit te Holandes, AOB.

Seminaret vijuan me raportimet e pjesemarresve rroi situaten ne shkollat perkatese ne baze te nje pyetesori te siperndare qe me pare, gje qe synonte te evidentonte problemet me kryesore ne lidhje me kete ceshtje ne keto rrethe dhe ne shkollat qe perfagesheshin ne keto seminare, si edhe te perpildheshin plane konkrete veprimi per keto rrethe e shkolla per nje pune me konkrete e me rezultative ne te ardhmen.

Ne raportimin qe beri ne Seminarin e Korçes, kryetari i seksionit sindikal te ketij methi, zoti Fildan Drabo, vuri ne dukje se gjate vitit shkollor 2004-2005 ne kete rreth jane 134 nxenes qe kane braktisur shkollen, 46 prej te cileve jane vajza. Keto shifra, theksoi ai, jane nder me te mirat gjate periudhes 1992-2005, por perseri numri eshte shume i larte dhe shqetesimi



Panje nga seminari i zhvilluar me ILO-IPEC ne Berat

shtohet kur pritet qe shumica e ketyre nxenesve t'u drejtohen fronteve te punes, perfshire edhe ato me te rrezikshmet. Nderkthe Kryetarja e Seksionit te SPASH-it per kete rreth, zonja Albina Pepo, dhe pjesemarres te tjere theksuan se akoma me i madh eshte numri i nxenesve qe jane ne rrezik per ta braktisur shkollen, gje qe duket ne vijimin me hope ose ne angazhimin e tyre me pune, megjithese pa e braktisur perfundimisht shkollen.

Ne seminarin e Beratit, shifrat qe paraqiten Kryetari i seksionit sindikal te FSASH-it Berat, Ylli Muxogllava, Kryetari i seksionit te SPASH-it, Joli Papa, Perfagesuesi i SPASH-it per Kuçoven, Jordan Devole, Kryetari i Seksionit te SPASH-it per Skraparin, Perparim Musabelliu dhe mjaft pjesemarres te tjere ne raportimet e tyre ishin me te ulta, por shqetesimi se numri i nxenesve qe rrezikojne te braktisin shkollen ishte shume evident nga shume pjesemarres, duke paraqitur si faktore kryesore, jo vetem anen

ekonomike, por edhe rolin e vete shkolles dhe mentalitetet qe nenfletojne rolin e saj, per shkak te mundesive te kufizuara qe ekzistojne per vazhdimin e shkolles se larte pas mbarimit te arsimit te detyrueshem.

Pothuajse nga te gjithë pjesemarresit ne te dy seminarët u theksua domosdoshmeria e nje

shume mesues per identifikimin e femijeve qe kane braktisur shkollen, te atyre qe jane ne rrezik per ta braktisur ate dhe te nxenesve me probleme ne vijim e ne mesime, me synim qe te organizohet nje pune e veçante me secilin prej tyre, ne bashkepunim me prinderit e me komunitetin,

-Te behen trajnime me nje numer sa me te madh mesuesish per Konventat 138 dhe 182, me qellim qe ata te njihen me standardet nderkombetare ne lidhje me punen e femijeve dhe te angazhohen per zbatimin e tyre,

-Te ndikohet tek drejtorite e shkollave dhe tek perfagesuesit e pushtetit lokal qe ne çdo skolle te sigurohet nje numer i domosdoshem veglash muzikore dhe mjetesesh te tjera sportive, dhe te behet i mundur financimi i disa aktiviteteve edukative me femijet, me qellim qe te te njihen sa me shume nxenes ne aktivitetet argetuese e zbatuese, si nje kusht i domosdoshem per para-ndalimin e largimeve nga shkolla,

-Te pergjidhet nje harte e shkollave ne shkalle rrethi, ku te evidentohen shkollat me me shume probleme dhe te synohet qe te punohet konkretisht ne menyre te diferencuar me keto shkolla, duke synuar qe te behen edhe aplikime per te siguruar ndilme nepemijet miniprogrameve qe mund te zbatohen,

-Nga ana e kryesive te FSASH dhe SPASH ne qender te shfrytesohen bisedimet per kontraten e re kolektive te punes per te perfshire ne nene te veçanta te saj ceshtjet qe kane te bejne me eliminimin e braktisjes se shkolles dhe te punes se femijeve, si edhe me perrimesimin e legjislacionit dhe masat shtrenguese per zbatimin e tij, ne rastet e braktisjes se shkolles,

-Te zbatohet nje program pilot te pakten ne 3-5 shkolla te rretheve pjesemarrese ne keto seminare per ngritjen e

-Te aktivizohen sa me

Vijon në faqen 8

Veprime konkrete dhe bashkepunim i gjere per eliminimin e punes se femijeve Nga Seminari i zhvilluar ne rrethin e Elbasanit

Ne vazhdim te aktiviteteve ne kuadrin e Projektit qe FSASH e SPASH kane me Sindikaten e Mesuesve te Holandes, AOB, dhe Konfederaten Holandeze te Sindikatave, FNV, ne Elbasan u zhvillua seminari treditore mbi angazhimin e sindikatave te arsimit per parandalimin e punes se femijeve. Ne seminarin moren pjese 24 drejtues lokale te FSASH e SPASH, perfaqesues te shkollave te rendesishme ne qytet e ne disa komuna dhe te disa shkollave qe kane me shume probleme ne shkalle nrethi. Ne seanca te posaqme moren pjese edhe perfaqesues te pushtetit lokal (Qarku, Bashkia dhe Drejtoria e Policise se nrethit) dhe nga disa OJQ te angazhuara ne aktivitate konkrete per eliminimin e punes se femijeve. Moren pjese, gjithashtu, ekspertet e Sindikates Holandeze te Mesuesve, AOB, Marten Kirch dhe Trudy Kerperien.

Programi i seminarit ishte shume i ngjeshur dhe interesant, bazuar ne nje kombinim efektiv te shpjegimeve teorike me veprime praktike, diskutime e debate dhe perpunimin e nje plani veprimi per periudhen ne vazhdim.

Ne ditën e pare Seminarin u hap nga Kryetari i Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, zoti Xhafer Dobrushi, i cili beri nje prezantim te programit te ketij seminarin ne kuadrin e aktiviteteve te Projektit dhe zberthoi disa nga synimet qe pratej te realizoheshin gjate te ditave te zhvillimit te tij.

Pas prezantimit te pjesemarrësve, Menaxherja Konbetare e ILO-IPEC ne Tirane, zonja Snezhi Bedalli, trajtoi temën ne lidhje me konceptin mbi punën e femijeve, standardet nderkonbetare, sipas konventave Nr.138 mbi moshën minimale te pranimit ne punesim dhe Nr.182 mbi format ne te keqija te punes se femijeve dhe legjislacionin shqiptar mbi mbrojtjen e femijeve dhe punet e nrezikesme.

Interes te vecante ngjalli tek pjesemarrësit Moduli SCREAM, i paraqitur ne seancen ne vijim nga zonja Snezhi Bedalli. Kjo ishte nje pakete shume interesante e cila mund te perdoret nga mesuesit per organizimin e aktiviteteve zhvitesse e krijese, me synim shmangien e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve. Te dyja keto seanca u shqeruan me aktivitate praktike ku moren pjese ne menyre masive te gjithë pjesemarrësit ne seminar.

Ne ditën e dyte paradite qendra e zhvillimit te seminarit u spostua ne shkollën 9-vjeçare "Jeronim De Rada" ku moren pjese, jo vetem pjesemarrësit e seminarit, por edhe mesues e nxenes te kesaj shkolle, prinder te femijeve qe mesojne ne kete shkolle, perfaqesues te OJQ-ve aktive ne aktivitetet e kesaj shkolle si edhe perfaqesuesit nga Holanda.

Ne fillim Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi dhe Sekretari i Pergjithshem i SPASH-it, zoti Defrim Spahiu bere shpjegimet e rastit

ne lidhje me angazhimin e ketyre sindikatave per mbrojtjen e femijeve dhe eliminimin e punes se tyre, duke u pergenduar sidomos tek puna konkrete e mesuesve dhe sindikatave ne shkolle, gje per te cilen do te diskutohet edhe ne kete seance ne shkolle.



Mesuesja Aferdita Lushe, se bashku me nxenesen e rikthyer ne shkolle pas nje pune konkrete, Xhuljeta Merya.

Ne prezantimin e vete, Kryetarja e SPASH-it per shkolle, zonja Nadire Taka, paraqiti situaten e shkolles, sidomos ne lidhje me braktisjen e saj nga disa nxenes problematike, si edhe përpjekjet qe kane bere sindikatat per nje angazhim konkret te mesuesve per t'u marrë me keta nxenes dhe ne disa nxenes te tjere qe jane me probleme dhe qe nrezikojne te hyjne ne kete muge. Nga 675 nxenes qe ka shkolle, theksoi ajo ne prezantimin e vete, jane te angazhuar ne pune te ndryshme duke e braktisur shkolle ose duke vijuar me hope 15 nxenes, ndekste qe 5 te tjere jane me probleme, 20 nxenes jane me nje prinder, 20 te tjere jane me prinder te divorcuar, pothuajse te gjithë keta objekt i nje pune te diferencuar, sidomos nga ana e mesuesve te klasave perkatese ose mesuesve kujdestare.

Drejtori i shkolles, Fatmir Musai, i cili qe ne fillim mizepanti organizimin e ketij aktiviteti ne shkolle dhe, se bashku me perfaqesuesit e sindikatave, ishte shume aktiv ne pergatitjen e tij, vuri ne dukje se ne kushtet e nje shkolle periferike me nxenes kryesisht nga familje te ardhura rishtaz ne rrethin e Elbasanit, 168 prej te cilave me asistencë dhe 60 familje me origjine egjiptiane, drejtorise dhe stafit pedagogjik te shkolles i eshte dashur te beje shume, jo vetem per përvetesimin e programeve

mesimre, por edhe per edukimin e nxenesve, shmangien e braktisjes se shkolles ose te vijimit me hope. Ai kerkoi me shume nga sindikatat e shkolles, nga seksionet sindikale ne rreth dhe nga organet qendrore te FSASH-it e SPASH-it per te bere me shume presion mbi Ministrine e Arsimit dhe Drejtorine Arsimore per me shume investime per nxenesit dhe mesuesit e shkolles, me qellim qe ata te motivohen per nje pune me cilesore dhe me rezultate ne aren e arsimit, por edhe jasht saj.

Mesuesja Elvira Leci paraqiti, ne vijim, pervojën e saj me nxenesit me probleme dhe rezultatet emocionuese qe u pranuan edhe nga vete nxenesit e pranishan ne salle. Shatuj te tille dhane edhe zv/Drejtorja Blerta Tahiraj dhe mesuese te tjera te kesaj shkolle, si edhe prinder e nxenes pjesemarrës ne aktivitet.

Drejtuesit e FSASH-it e SPASH-it dhe perfaqesuesit e AOB vleresuan pervojën e kesaj shkolle dhe e konsideruan ate si nje shatuj i mire per nje pune edhe me rezultate, jo vetem ne kete shkolle, por edhe ne shkollet e tjera te ketij nrethi.

Seanca e mbesdites, e zhvilluar ne sallen e seminarit, u pergendua gjeresisht tek puna e dy sindikatave te arsimit te ketij nrethi dhe tek nevoja per nje koordinim e bashkepunim me te mire me Drejtorine Arsimore, me organet e pushtetit lokal, (Prefektura, Qark e Bashki), si edhe me organizatat e tjera joqeveritare qe jane aktive per keto probleme ne Elbasan.

Ne emer te Grupit te Punes qe funksionon ne kete nreth ne kuadrin e Projektit me AOB-FNV, Kryetarja e seksionit sindikal te SPASH-it per Elbasanin, zonja Bukuroshe Shabani, paraqiti situaten, problemet dhe disa nga detyrat kryesore per te ardhmen. Ajo u ndale kryesisht tek nxenesit qe kane braktisur shkolle ne qytet e ne komuna, shkaqet e kesaj gjendjeje (varferia, mentaliteti, problemet e prinderve) dhe nenvizoi vlerat e perfshirjes se sindikatave te arsimit te Elbasanit ne aktivitetet e Projektit me AOB - FNV.

Me tej, kryetari i seksionit te FSASH per Elbasanin, zoti Osman Nika beri disa shpjegime ne lidhje me domosdoshmerine e motivimit me te mire te mesuesve per t'u marrë me menyre te diferencuar me keto probleme, duke shfrytëzuar edhe rastin e negociatave qe jane ne proces me Ministrine e Arsimit dhe Shkences per Kontraten e re kolektive te punes, si edhe duke kerkuar nje vleresim me te mire te punes se mesuesve kujdestare.

Diskutimet e perfaqesuesve te Bashkise, te Qarkut dhe te Drejtorise se Policise, te cilet ekspozuan situaten ne lidhje me sektoret perkates, paraqiten planet per angazhimet ne te ardhmen dhe kerkuan me shume bashkepunim me sindikatat e mesuesit, jo vetem per parandalimin e braktisjes se shkolles, por

Tre prononcime te Kryetareve te Grupeve te Punes ne Fier, Elbasan e Tirane per angazhimin e sindikatave te arsimit ne luften kunder punes se femijeve

Lavdosh Llana

Kryetar i Grupit te Punes, Fier

Si kudo, edhe në rrethin tonë, preokupacioni më i parë dhe më i madh është mirërritja dhe edukimi i fëmijëve. Sa më shumë fëmijë të shkojnë në shkollë, aq më pak kanë ata mundësi të detyrohen të punojnë, ndaj ky ka qenë problemi dhe shqetësimi i sindikatave tona në arsim.

Kur flasim për shkollën, gjëja e parë që vjen në mend është fjala "reformë". Mirëpo shkolla është një institucion shumë i gjërë, misioni i së cilës është të mësojë fëmijët që të ndryshojnë botën, kjo do të thotë që e gjithë shoqëria të mendojë e të punojë për ta. Shoqëria, duke zhvilluar shkollën, përparon e zhvillon vetveten, prandaj problemi që ne diskutojmë është shumë i rëndësishëm.

Nga ndjekja dhe analiza që i është bërë problemit të braktisjes së shkollës nga fëmijët, sindikatave tona dhe drejtoritë e shkollave tregojnë se përqindja e fëmijëve në moshën e detyrimit shkollor që nuk shkojnë në shkollë për vitet 2002-2003 në shkallë rrethi është 1,26%, e barabartë me 398 fëmijë, për vitin 2003-2004 ka një ulje në 0,75%, e barabartë me 239 fëmijë, ndërsa për sinestrin e parë 2004-2005 është 0,62%, e barabarët me 186 nxënës.

Në zbatim të programit të projektit të

FNV-AOB, për eliminimin e punës së fëmijëve, në bashkëpunim me dy sindikatave qëndrore të arsimit FSASH dhe SPASH, puna është përqëndruar konkretisht në shkollën 9-vjeçare Levan e Morostar-Ura, edhe pasi ka përqëndrim më të mëdha të popullsisë romë.

Pas ndihjes me projektin u ngritën grupet e punës me përbërje nga dy sindikatave, përfaqësues të pushtetit vendor, Drejtorisë Arsimore të Qarkut, shoqatës së romëve të rrethit e të komunitetit ku u përcaktuan detyra konkrete për secilin anëtar të grupit.

Nga ndjekja nga afër e këtij problemi dhe nga takimet e realizuara me prindërit romë në Komunën Morostar-Ura, së bashku edhe me përfaqësuesit e pushtetit vendor, u arrit që afro 20 fëmijë romë që janë brenda detyrimit shkollor të vazhdojnë arsimin bazë për vitin 2005-2006. Po aty doli si problem krijimi i mundësive nga ana e shkollës Morostar-Ura i ngritjes së ndonjë kursi për ata fëmijë që janë jashtë detyrimit shkollor. Kjo tregon se po të punosh e të bidesosh, të komunikosh drejt përsëdrejti me fëmijë e prindër, marrin rezultate pozitive. Por përvoja në këtë drejtim nuk ka munguar. Këtu janë të pranishëm drejtuesit kryesor të shoqatës së romëve të rrethit të cilët me këmbëngulje e pasion për shkollën, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin

vendor, drejtorinë e shkollës, sindikatave e komunitetin kanë rezultate shumë të mira dhe konkretisht:

68 fëmijë romë vijnë rregullisht procesin mësimor. Janë evidentuar për të tërhequr nga rruça fëmijët lypsa si në qytetet Fier, Patos e Roskovec, shifra e të cilëve është 18 fëmijë të moshës 6-7 vjeç të cilët nuk përfshihen në numrin e fëmijëve romë që vijnë rregullisht arsimin bazë. Gjithashtu janë ngritur edhe grupet kundër analfabetizmit me familjet romë për moshën mbi 16 vjeç në komunën Levan, bashkinë Roskovec etj.

I parë në tërësinë e vet problemi për të cilin do diskutojmë, ne mendojmë se shkaqet e largimit nga shkolla të fëmijëve dhe pura e tyre janë:

Së pari, Gjendja ekonomike, papunësia.

Mungesa e zënies me punë është faktori më i rëndësishëm që shpjegon varfërinë e familjes, pra shfrytëzimin e punës së fëmijëve. Statistikat zyrtare të papunësisë flasin për një papunësi në vitin 2004 prej 12,1%. Ne si sindikata shprehim keqardhje për faktin se kjo përqindje e të papunëve është për të papunët afatgjatë. Në konsideratën tonë si dhe nga vëzhgimet e bëra na rezultoi se përqindja është akoma më e madhe. Të jetuarit në një familje vetëm me një asistencë sociale që nuk mund të mbulojë nevojat më të domosdoshme e

Trajnime dhe plane veprimi konkrete per parandalimin e punes se femijeve

Nga seminarat e organizuara me ILO-IPEC ne Korçe dhe Berat.

Vijon nga faqja 7

stendave te sindikatave ku te afishohen materiale te ndryshme qe lidhen me eliminimin e punes se femijeve,

- Te krijohen Grupe te veçanta koordinuese ne baze rrethi, (Korçe, Berat), per ndjekjen e zbatimit te planeve te veprimit dhe per zgjerimin e angazhimit te mesuesve ne problemet qe lidhen me eliminimin e punes se femijeve.

Si ne Korçe, ashtu edhe ne Berat iu kushtua një kujdes i veçantë përdorimit të medias për t'u bërë jehonë seminarëve dhe për siguruar një angazhim gjithnjë e më të gjërë të të gjithë mesuesve për këto probleme kaq të rëndësishme për nxënësit, për fëmijët dhe për gjithë shoqërinë tonë. Përveç pasqyrit të këtyre seminarëve në televizionet lokale dhe në ato knibetare,

nepërmjet korrespondentëve lokale, ne të dy rrethet u bënë emisione të posaçme në lidhje me seminarat dhe me angazhimin e sindikatave të arsimit e sindikatave të tjera, në bashkëpunim me Zyrën e ILO-IPEC në Tirane, për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e punës së tyre. Në emisionin e drejtperdrejtë që u organizua në TV Lobi në Korçe, Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushit, Menaxherja Knibetare e ILO-IPEC në verdin tone, zonja Snezhi Bedalli dhe Drejtoresha e Shkolles « Demokracia » Kostanca Qari, trajtuan hollësisht punën e bërë në shkollë vendi dhe veçanësisht në rrethin e Korçes, në lidhje me këtë problem, duke bërë thirrje për një angazhim të gjithëve dhe të të gjitha strukturave për eliminimin e punës së fëmijëve.

Kjo gjë u theksua edhe në emisionin e

posaçem që u transmetua nga TV Onufri dhe në lajmet që transmetuan disa televizione të tjera lokale në Berat.

Në përfundim të të dy seminarëve, me një formë shumë interesante, secili prej pjesëmarrësve bëri vlerësimin e seminarit në lidhje me kater çështje kryesore që kishin të bënin me të: niveli i organizimit, niveli i trajnuesve, metodat e përdorura dhe materialet e vena në dispozicion të pjesëmarrësve. Organizatorët e seminarëve nxorën mesazhin e nevojësime në lidhje me vlerësimet pretenduese për ne shumë, gjë që do të mbahet parasysh në aktivitetet në vijim të këtij programi ose të projekteve të tjera që pritet të zbatohen dy sindikatave e arsimit në lidhje me eliminimin e punës së fëmijëve në verdin tone.

Stavri Liko

vështirëson problemin.

Së dyti, Niveli i pagave. Niveli i pagave aktualisht është akoma i ulët, ndërkohë që kostoja e jetesës nuk rresht së rrituri këto vitet e fundit. Ne si sindikata të bazës mendojmë se një rivlerësim i ri i pagave do të çojë pa diskutim në një pëmirësim të gjendjes ekonomike në familje dhe do të largonte fëmijët nga punët që ata kryejnë.

Së treti, Shpërngulja e brendshme. Panumësia për të siguruar te ardhurat dhe jetuar në disa fshatra i ka shtyrë dhe vazhdon t'i shtyrë qindra familje që të zhvendosen drejt qendrave urbane. Këto shpërngulje të brendshme kanë nxitur krijimin e periferive të mëdha pranë qyteteve. Për rrjedhojë shumë familje të shpërngulura nuk kanë mundur të punësohen, kështu që një pjesë e tyre janë të detyruara të futin në punë edhe fëmijët e tyre për të ndihmuar sado pak gjendjen e vështirë ekonomike, pavarësisht se pretendimi i këtyre familjeve është për një jetë më "të mirë". Nuk janë të pakta rastet kur i shikon fëmijët që të lajnë makinat, të lypin, të shesin prodhime të ndryshme anës rrugëve etj. Këto lëvizje të familjeve kanë sjellë edhe pasoja administrative. Disa prej tyre nuk kanë kryer formalitetet e nevojshme për t'u regjistruar pranë bashkive e komunave ku ata kanë vendosur të banojnë gjë që e ndërlikon akoma më shumë kontrollin dhe regjistrimin e fëmijëve për arsimin e detyrueshëm.

Së katërti, Ekzistenca e disa familjeve me probleme. Fëmijët me një prind, familje të ribëra, divorcet, largimet jashtë shtetit të njërit prej prindërve përbëjnë një nga shkaqet për problemin që sot po diskutojmë. Përkeqësimi i gjendjes ekonomike i disa familjeve i ka shtyrë ato drejt nritjes së tensionit brenda familjes i cili ndikon negativisht tek fëmijët si pjesëtarë të kësaj familje.

Së pesti, Mungesa e ndërgjegjësimit të disa familjeve për rëndësinë e shkollës. Kur prindërit janë të bindur për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve, gjendet mundësia për vazhdimin e shkollës, por kur disa familjeve u mungon tradita familjare për domosdoshmërinë e shkollimit, e shohin atë pa prespektivë (mundësia e zënies me punë) pas mbarimit të shkollës. Mpleksja e këtyre arsyeve dhe të tjera si këto i shtyrë keto familje të lënë pas dore shkollimin e fëmijëve.

Prandaj, sindikatat së bashku me drejtoritë e shkollave, duhet t'i motivojnë mësuesit që të futen shtëpi në shtëpi, të bisedojnë me prindër e të afërm (siç bëhet aktualisht në shkollën 9-vjeçare Levan) se vetëm kështu mund e duhet t'i bindim ata për domosdoshmërinë dhe rëndësinë e shkollës për fëmijët e tyre. Veçojmë kontributin shumë të madh që kanë dhënë stafi pedagogjik i shkollës Levan, si drejtori, Z. Tonorr Hoxha si dhe anëtarët e sindikatave së mësuesve me kryetare znj. Luljeta Kovaçi.

Së gjashti, Zbatimi i keq i ligjit për detyrimin shkollor dhe moshën minorene për punë të fëmijëve. Ne si sindikata do t'i kërkonim zbatuesit të ligjit që të vendosë sanksionet e nevojshme ndaj personave që punësojnë fëmijë nën moshën ligjore për punë, ndërkohë do t'i kërkojmë pushtetit vendor që të ndjekë Shkelja e dispozitivave ligjore që kanë të bëjnë me arsimin e detyruar nuk ndiqet e zbatohet sa e si duhet nga pushteti vendor.

Çfarë rezultoi: Në ciklin e ulët kemi më pak braktisje të shkollës nga fëmijët, ndërsa në ciklin e lartë numri i fëmijëve që braktisin shkollën është më i madh pasi kjo moshë mund të përshtatet në llojet e punëve të përshtuara në lart.

Për vazhdimësinë e zbatimit të projektit në të ardhmen mendojmë se dalin disa detyra:

a. Institucionalizimi i kësaj veprimtarie të zhvilluar deri tani dhe puna në grupe është detyra e parë që do të kemi për të ardhmen.

b. Përgjithësimi i shembullit të më të mirëve në arritjen e rezultateve në shkolla të ndryshme të rrethit tonë nëpërmjet veprimtarive sindikale e takimeve të ndryshme.

c. Ngritja e shërbimit psiko-social dhe pedagogjik pranë shkollave në ndihmë të fëmijëve, prindërve, mësuesve si të përballohen problemet e fëmijëve që frekuentojnë në hope.

d. Kualifikimi i mësuesve për çështjet sociale për ndërgjegjësimin e nxënësve dhe prindërve.

e. Sensibilizimi i opinionit nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj vizive për detyrimet që kanë prindër e fëmijë ndaj shkollës.

f. Të zbatohen sanksione financiare ndaj prindërve që pengojnë fëmijët e tyre të vazhdojnë shkollën, brenda detyrimit ligjor.

Bukuroshe Shabani

Kryetare e Grupit të Punës, Elbasan

Sindikatat e arsimit në rrethin e Elbasanit, SPASH dhe FSASH, kanë konstatuar se në mjaft shkolla të rrethit tone, megjithë punën që është bërë nga të gjitha strukturat, ka akoma dukuri shqetësuese si braktisje të shkollës nga nxënës të sistemit të arsimit të detyrueshëm, vijim me hope etj, të cilat ne i konsiderojmë një rrezik për rritjen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën.

Për vitin 2004-2005 në rrethin e Elbasanit e kanë braktisur shkollën 335 nxënës, prej të cileve 116 ishin të



Në njerën nga seancat e seminarit në Shkollën "Jeronim De Rada" në Elbasan

angazhuar në punë.

Në një analizë me të hollësishme, gjendja në lidhje me braktisjen ndryshon nga njëra shkollë në tjetrën. Kështu në shkollën 9-vjeçare «Abdyl Myzyri» e kanë braktisur shkollën 17 nxënës, 4 prej të cileve janë të angazhuar në punë, ndërkohe që janë në rrezik për ta braktisur atë edhe 2 nxënës të tjerë. Në shkollën 9-vjeçare «Jeronim De Rada» e kanë braktisur shkollën 8 nxënës, ndërkohe që janë edhe 3 të tjerë në rrezik për ta braktisur atë. Në shkollën 9 vjeçare «Hamit Mullisi» e kanë braktisur shkollën 5 nxënës, ndërkohe që janë në rrezik për ta braktisur atë edhe 2 të tjerë. Në shkollën 9 -vjeçare «9 Marsi» Gërrik e kanë braktisur shkollën 22 nxënës, prej të cileve janë të angazhuar në punë 5 fëmijë, ndërkohe që janë në rrezik për ta braktisur shkollën edhe 9 nxënës të tjerë.

E tilla është gjendja pak a shumë edhe në shkollat e fshatit. Kështu në Brachshesh e kanë braktisur shkollën 11 nxënës, prej të cileve 4 janë të angazhuar në punë dhe janë në rrezik për ta braktisur atë edhe 4 nxënës të tjerë. Në Shushice e kanë braktisur shkollën 11 nxënës dhe janë në rrezik për ta braktisur atë edhe 4 nxënës të tjerë. Fenomeni shtrihet edhe në Xibrake, Labinot Fushe, Mollas, Plangorice etj, ku nxënësit që kanë

Vijan nga faqja 9

braktisur shkollen jane te angazhuar kryesisht ne punet e bujtesise.

Arsyet kryesore te braktisjes se shkollës dhe angazhimit te femijeve ne pune kane te bejne sidomos me kushtete veshtira financiare te familjeve te tyre, qe vijne si rezultat i papunesise se prinderve, i ekzistences se familjeve me probleme (me prinder te divorcuar ose ne emigracion), i levizjeve demografike qe shkaktojne probleme per jetesen, i moszbatimit te legjislacionit qe ka te bejne me arsimin e detyrueshem etj.

Nuk ka asnje dyshim se mbetet akoma shume per te bere nga ana e mesuesve dhe sindikatave te tyre per permiresimin e gjendjes ne lidhje me kete qeshtje. Gjate sesionit te seminarit ne shkollen «Jeronim De Rada» doli e qarte se puna kembenguluese e disa mesuesve te kesaj shkolle me nxenes te veshtire ka rezultuar me kthime te disa nxenesve ne shkolle dhe integrimin e tyre ne aktivitetet normale te shkolles.

Ne rrethin tone ka edhe shkollla ku ky fenomen nuk eshte shume evident, gje qe eshte edhe rezultat i punes konkrete dhe te veçante te mesuesve dhe dy sindikatave tona, te cilat duhet te rakordojne edhe me mire veprimet midis tyre, sepse ato per te njejtat qellime punojne.

Per vitin shkollor 2005-2006 presim permiresime te metejshme, por kjo kerkon qe ne te angazhemi me te gjitha forcat per te zbatuar planet e veprimit qe kemi hartuar per periudhen ne vazhdim, duke u pergjendur sidomos ne keto drejtime:

- te rritet angazhimi i mesuesve, sidomos i mesuesve kujdestare per t'u marre me nxenesit me probleme ne vijim e ne mesime,

- te forcohet bashkepunimi me drejtorite e shkollave per te planifikuar e organizuar aktivitate te lamishme per terheqjen e sa me shume nxenesve ne to dhe nritjen e interesimit te tyre per shkollen dhe mesimin,

- te nxitet puna e diferencuar me nxenesit me probleme duke aktivizuar jo vetem mesuesit, por edhe bordet e prinderve dhe vete senatet e shkollave, duke pare mundesine e organizimit edhe te disa trajnime me ta.

Natyrisht kjo pune e gjithanshme e mesuesve duhet edhe te stimulohet me trajtime me te mira per ta, duke pare mundesine e motivimit me te mire ose nepemjet formave te tjera qe duhen kerkuar nga ana e sindikatave.

Derall Tota

Kryetar i Grupit te Punes, Tirane

Mbeshtetur ne kerkesat e kohës, misioni i shkollës është: "Mësojini fëmijët që të ndryshojnë botën". Kjo do të thotë që e gjithë shoqëria të mendojë e të punojë për ta. Shoqëria duke zhvilluar shkollën përparon e zhvillon vetveten. Prandaj problemi që po diskutojmë është shumë i rëndësishëm se po rritet numri i fëmijëve që braktisin shkollën.

Zona e Kamzës është një zonë rurale ku 80 % e saj janë të ardhur nga 74 komuna të sidomos nga zona verilindore, zona të varfëra. Mesatarisht familjet janë nga 5-8 anëtarë, drit qdo familje ka nga 4-6 fëmijë. Rreth 40 % e familjeve nuk kanë të ardhurat minimale për jetesë dhe ata që punojnë shumica janë në punë

të zezë. 15 % e prindërve punojnë në emigracion; nënat nuk punojnë. Arsimi i prindërve lë për të dëshnuar.

2,5 % janë me arsim të lartë, 56 % me arsim 8-vjeçar dhe 41,5 % me arsim të mesëm, shumica e tyre me arsim bujqësor.

Zona e Kamzës, bashki e nivelit të parë, ka tetë shkolla 9-vjeçare dhe një të mesme. Numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare është shumë i populluar, ku shkollat punojnë me 2-3 turme, gjë që po çon në cingëritin e njohurive të nxënësve, dhe në braktisjen e shkollës nga ana e tyre. Në vijim është një pasqyrë e numrit të nxënësve që kane braktisur shkollen gjate vitit 2004-2005:

	Gjithesej	Femra	Meshkuj
1 Shkolla Bathore 1 dhe Bathore 2	81	47	34
2 Shkolla	48	33	15
3 Shkolla Kamëz Qendër	42	24	18
4 Shkolla Kamëz e Re	24	16	8
5 Shkolla Zallher	31	21	10
6 Shkolla Laknas	72	42	30
7 Shkolla Valias	23	18	15
SHUMA :	321	201	130

Braktisja e shkollës nga ana e vajzave është 2 me 1 në raport me djentë. Për mendimin tonë, kjo vjen si rezultat i mungesës së arsimit të prindërve, veçanërisht të nënave, i mungesës së kulturës së familjeve te zonave rurale, i traditës së familjeve shqiptare veriore ku graja (vajza) merret me punët e shtëpisë.

Frika nga socializimi jashtë shtëpisë i fëmijës vajzë, mentaliteti dhe konceptimi fanatik i imazhit të saj përbëjnë të tjera arsye të cilat justifikojnë ndërpërjen në të shpejtë të arsimit nga ana e vajzave.

Largimi i djave nga shkolla vjen si rezultat i detyrimit të përcaktuar nga kushtet ekonomike madje edhe nga vetë prindërit të cilët janë pa punë dhe largojnë fëmijët nga shkolla për të punuar. Rreth 40 % e nxënësve meshkuj bëjnë punë të ndryshme si shesin paketa, bëjnë faturimin në furgona, mbledhin kanaqe etj.

Një arsye tjetër është është ajo sociale që ka të bëjë me fëmijët me një prind, rastet e vdekjes së njërit prind dhe shumë pak divorce apo me probleme shëndetësore.

Një rast tjetër është ai i djave që kanë mbetur disa herë në një klasë. Vetë fëmijët konstatojnë se rezultatet e shkollës: "nuk e justifikojnë kohën e shpenzuar në shkollë", kohë e cila do të ishte më e vlefshme duke punuar.

Kjo gjendje është, gjithashtu, pasojë e mungesës së interesit nga ana e disa prindërve, e mospërshtatjes së shpejtë me ritmin e vullshëm të jetës në kryeqytet dhe e moszbatimit të ligjit shkollor nga ana e pushtetit

vendor.

Këto veçori shprehen edhe në ciklin e ulët, ku vetëm 34 fëmijë kane braktisur shkollen, nga të cilët 10 në klasë të parë, mërsa në ciklin e lartë kjo shifer shkon në 268 nxënës. Problem është se disa nxënës që braktisin shkollën janë të pa regjistruar në zyrtarë e gjendjes civile. Në dy shkollat e Kamzës të tillë janë 66 nxënës, nga të cilët 39 janë femra. Vetëm nga shkolla e Laknasit janë larguar 72 nxënës nga të cilët 42 janë femra. Krahasuar me numrin e nxënësve, shkolla e Laknasit ka 2,3 herë më pak nxënës që braktisin shkollën se shkollat e Kamzës. Ndërsa për sa u përket femrave, në Kamëz, pavarësisht se është shkollë e vjetër, me traditë, ky fenomen është shpëtësues, sepse ka disa raste braktisjesh që në klasë të parë.

Disa nga detyrat që propozohen nga ana janë janë:

- Ngritja e shërbimit psiko-social dhe pedagogjik pranë shkollave në ndihmë të fëmijëve, prindërve dhe mesuesve se si të përballojnë problemet e fëmijëve që frekuentojnë shkollën me hope.

- Kualifikimi i mesuesve për qeshtjet sociale dhe psikologjike për ndërgjegjesimin e nxënësve dhe prindërve

- Sensibilizimi i opinionit nëpërmjet medias dhe shtypit për eliminimin e braktisjes së shkollës.

- Nëntimi i shkollave të reja dhe nxitja e marjes se masave sociale nga shteti, sidomos per familjet qe kane me shume probleme financiare.

REZOLUTË E KONGRESIT TË TRETË TË FSASH

Mbi zgjerimin e angazhimit të strukturave të FSASH për parandalimin e punës së fëmijëve

Kongresi i Tretë i FSASH, i mbledhur në Tiranë në datat 5 dhe 6 nëntor 2004, mbasi diskutoi në lidhje me përfshirjen dhe rritjen e rolit të FASH në luftën kundër punës së fëmijëve, miratonte këtë Rezolutë:

1. Kongresi vlerëson punën e deritanismë në lidhje me përfshirjen dhe angazhimin e strukturave të FSASH për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e punës së tyre.

2. Kongresi ngarkon Këshillin Drejtues dhe Kryesinë e FSASH që të zgjerojnë angazhimin e tyre, sidomos në drejtim të trajnimit të drejtuesve sindikalistë në nivel qendror e lokal, me qëllim që ata vetë të njohin standardet ndërkombëtare në lidhje me punën e fëmijëve dhe të punojnë për të zgjeruar rrjetin e mësuesve që mund të merren me këtë çështje.

3. Një ndër drejtimet e rëndësishme të Kryesise së FSASH në qendër, të seksioneve sindikale në rrethe dhe të këshillave sindikale në shkolla të jetë puna me nxënësit që kanë braktisur shkollën ose që rezikojnë ta braktisin atë, si kontingjenti më i mundshëm i punës së fëmijëve dhe trafikimit të tyre.

Për këtë, të ndëmerren veprime konkrete në shkallë vendi e sidomos në 4-5 rrethet me numrin më të lartë të braktisjes së shkollës, (Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Durrës, Korçë), me synim që brenda një periudhe dy vjeçare të ulen numri i nxënësve që braktisin shkollën në këto rrethe me jo më pak se 25 përqind dhe në nivel kombëtar me jo më pak se 10 përqind.

4. Kryesia e Federatës të forcojë bashkëpunimin me ILO-IPEC në Tiranë, me

qëllim që strukturat e FSASH në qendër e në nivel lokal të përfshihen në aktivitetet e organizuara në kuadrin e projekteve për luftën kundër punës së fëmijëve, ose të aplikojnë e zbatojnë vetë projekte në këto fushë, duke ndërmarrë veprime, konkrete me synim uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe të fëmijëve që punojnë.

5. FSASH të aplikojë e zbatojë projekte në bashkëpunim me Internacionalen e Arsimit, EI, dhe me organizatat sindikale simotra, me synim angazhimin në aktivitetet konkrete për parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit me probleme dhe rritjen e numrit të mësuesve të angazhuar në luftën kundër punës së fëmijëve.

6. Të zgjerohet me tej bashkëpunimi me Organizatat Jofitimpruresë, OJF, shoqëtarë që janë të ngazhuara në këtë fushë dhe të punohet për një bashkëpunim të mëtejshëm me komunitetin, administratat e shkollave, organet e pushtetit vendor dhe vetë nxënësit e fëmijët për të krijuar një front të përbashkët kundër punës së fëmijëve.

7. FSASH të zgjerojë bashkëpunimin me Sindikatën e Pavarur të Arsimit Shqiptar, SPASH, dhe të bëhet nxitëse për përfshirjen edhe të sindikatave të degëve të tjera në luftën kundër punës së fëmijëve, duke organizuar aktivitetet të vecanta ose duke i përfshirë drejtuesit e këtyre sindikatave në aktivitetet e organizuara prej saj.

8. Të sigurohet një bashkëpunim më i mirë me Qendrën e Trajnimit dhe Studimeve Sindikale për organizimin e seminareve

dhe trajtimin e terave të mbrojtjes së fëmijëve dhe eliminimit të punës së tyre me drejtuesit sindikalistë të arsimit dhe të degëve e profesioneve të tjera, si edhe për ndërmarrjen e studimeve e vëzhgimeve në lidhje me punën e fëmijëve, shkaqet, drejtimet e punës për reduktimin e saj, përmirësimet ligjore etj, konkluzionet e të cilave të shërbejnë si bazë për veprime konkrete të strukturave sindikale në qendër e në nivel lokal.

9. Seksionet sindikale në rrethe dhe këshillat sindikale në bazë të ndërmarrin veprime konkrete për evidentimin e gjendjes së nxënësve që braktisin shkollën dhe të fëmijëve që punojnë, me qëllim që, në bashkëpunim me administratat e shkollave dhe komunitetin, të angazhohen për uljen e numrit të tyre.

10. Të ndikohet në Këshillin Kombëtar të Punës, me synim që të analizohet problemi i punës së fëmijëve dhe të merren vendime në lidhje me angazhimin e strukturave qeveritare qendrore e lokale për reduktimin e saj, sidomos nëpërmjet forcimit të inspektoriatit të punës dhe ndihmës për familjet me probleme, që, për shkak të mbiqesës, i largojnë fëmijët nga shkolla dhe i detyrojnë të punojnë.

11. Gjatë negociimeve që do të bëhen me Ministrinë e Arsimit e të Shkencës dhe Ministrinë e Pushtetit Vendor për Kontratën e re Kolektive të Punës, të përfshihen edhe problemet që lidhen me parandalimin e punës së fëmijëve, sipas pikave që përfshihen edhe në këtë Rezolutë.

Çast nga miratimi i Rezolutes mbi punën e fëmijëve në Kongresin e tretë të FSASH



REZOLUTË E KONGRESIT TË TRETË TË KSSH

Mbi zgjerimin e angazhimit të strukturave të KSSH për eliminimin e punës së fëmijëve

1. Kongresi vlerëson punën e dëritanishme në lidhje me përfshirjen dhe angazhimin e strukturave të KSSH për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e punës së tyre, dhe ngarkon Këshillin Drejtues dhe Kryesinë e saj që të zgjerojnë angazhimin e tyre, sidomos në drejtim të trajnimit të drejtuesve sindikalistë në nivel qendror e lokal, me qëllim që ata vetë të njohin standardet ndërkombëtare në lidhje me punën e fëmijëve dhe të punojnë për të zgjeruar rrjetin e drejtuesve sindikalistë që mund të merren me këte çështje.

2. Kryesia dhe Komiteti Ekzekutiv i KSSH të forcojnë bashkëpunimin me ILO-IPPC në Tiranë, me qëllim që strukturat e KSSH dhe të Federatave në përbërje të saj, në qendër e në nivel lokal, të përfshihen në aktivitetet e organizuara në kuadrin e projekteve për luftën kundër punës së fëmijëve, ose të aplikojnë e zbatojnë vetë projekte në këtë fushë, duke ndërmarrë veprime konkrete me synim uljen e numrit

të fëmijëve që punojnë.

3. KSSH të aplikojë e zbatojë projekte në bashkëpunim me ICFTU dhe me organizatat sindikale simotra, me synim ngritjen dhe funksionimin e strukturave të posaçme dhe angazhimin në aktivitete konkrete për parandalimin e punës së fëmijëve,

4. Të zgjerohet më tej bashkëpunimi me Organizatat Jofitimpruese, OJF, shoqëritë që janë të ngazhuara në këtë fushë dhe të punohet për një bashkëpunim të mëtijshëm me komunitetin, organet e pushtetit vendor dhe vetë mënësit e fëmijët për të krijuar një front të përbashkët kundër punës së fëmijëve.

5. Të sigurohet një bashkëpunim më i mirë me Qendrën e Trajnimit dhe Studimeve Sindikale për organizimin e seminarëve dhe trajnimit e tanave të mbrojtjes së fëmijëve dhe eliminimit të punës së tyre me drejtuesit sindikalistë, si edhe për ndërmarrjen e studimeve e vëzhgimeve në lidhje me

punën e fëmijëve, shkaqet, drejtimet e punës për reduktimin e saj, përmirësimet ligjore etj, konkluzionet e të cilave të shërbejnë si bazë për veprime konkrete të strukturave sindikale në qendër e në nivel lokal.

6. Të ndikohet në Këshillin Kombëtar të Punës, me synim që të analizohet problemi i punës së fëmijëve dhe të merren vendime në lidhje me angazhimin e strukturave qeveritare qendrore e lokale për reduktimin e saj, sidomos nëpërmjet forcimit të inspektoriatit të punës dhe ndihmës për familjet me probleme, që, për shkak të mbi jetesës, i largojnë fëmijët nga shkolla dhe i detyrojnë të punojnë.

7. Gjatë negociimeve që do të bëhen nga Federatat në përbërje të KSSH për kontratat e reja kolektive të punës, të përfshihen edhe problemet që lidhen me parandalimin e punës së fëmijëve, sipas pikave që përfshihen edhe në këtë Rezolutë.

KONKLUZIONE TË KONFERENCËS SË ICFTU MBI RRITJEN E ANGZHIMIT TË KSSH DHE BSPSH PËR ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE



Pamje nga zhvillimi i punimeve të Konferencës së KSSH dhe BSPSH, bashkëpunim me ICFTU mbi eliminimin e punës së fëmijëve

Konferenca, e zhvilluar në tetor të vitit 2004, përcaktoi disa nga veprimet që duhen ndërmarrë nga dy qendrat sindikale kombëtare, KSSH dhe BSPSH, për luftën kundër punës së fëmijëve:

-Të bëhen vëzhgime mbi punën e fëmijëve në sektorë të ndryshëm, të cilat të kryhen ose të mbikqyren nga ana e Federatave sindikale, sipas degëve të ekonomisë.

-Veçanërisht sindikatat e arsimit, të ndërmarrin veprime konkrete për ngritjen e ndërgjegjësimit të mësuesve mbi rëndësinë e të qenit aktivë në luftën kundër punës së

fëmijëve.

-Organizimi dhe mbështetja e përfshirjes së punës së fëmijëve në kontratat kolektive, veçanërisht në sektorin privat.

-Organizimi i trajnimeve profesionale për fëmijët që kanë braktisur shkollën ose që janë në vështirësi e në rrezik.

-Të ngrihet çështja e punës së fëmijëve në mënyrë aktive në organet tripartite. Autoritetet qeveritare dhe punëdhënësit kanë një rol kyç në luftën kundër punës së fëmijëve. Në duhet të bëjnë më shumë presion ndaj tyre për të vepruar në

përputhje me rëndësinë e fëmijëve për të ardhmen e vendit.

-Bashkëpunimi me inspektorët e punës për të denoncuar punëdhënësit që punësojnë fëmijë, si edhe me autoritete e partnerë të tjerë për të identifikuar fëmijët që punojnë.

-Krijimi i një Komiteti Monitorimi mbi punën e fëmijëve, i cili mund të koordinonte ose ndërmerrte vëzhgime për punën e fëmijëve në nivel kombëtar dhe do të shpërndante materiale propagandistike kundër punës së fëmijëve.

-Të bëhet presion për ta pasur punën e fëmijëve në axhendën e qeverisë, duke e kombinuar atë me përpjekjet e përbashkëta për eliminimin e punës informale.

-Përfshira e çështjes së punës së fëmijëve në Memorandumin e Mirëkuptimit, (i cili tani për tani është një draft), midis sindikatave, qeverisë dhe përfaqësuesve të biznesit.

-Të bëhet presion mbi punëdhënësit Europian e Ndërkombëtar, si edhe të bashkëpunohet më mirë me sindikatat ndërkombëtare dhe me qendrat sindikale kombëtare.

Aktivite efektive të IPEC në Shqipëri

Programi Ndërkombëtar i ILO-s për eliminimin e punës së fëmijëve, IPEC, ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me qeverinë shqiptare në qershor të 1999-ës, me synimin e ndalimit progresiv, kufizimit dhe eliminimit të punës së fëmijëve në Shqipëri dhe ngritjen e ndërgjegjësimit në nivel kombëtar mbi problemet, pasojat dhe zgjidhjen e çështjes së punës së fëmijëve.

Fushat prioritare të IPEC në Shqipëri përfshijnë:

- Përgatitja e një kuadri të strategjisë kombëtare për të luftuar punën e fëmijëve në vend, që përfshin të gjitha organizatat partnere që kanë lidhje me problemin.

- Rritja e kapaciteteve kombëtare të ministrive që kanë lidhje me çështjen e punës së fëmijëve.

- Rritja e kapaciteteve të partnerëve socialë dhe OJQ-ve për të zbatuar programe veprimi të drejtpërdrejta për të parandaluar fëmijët në rrezik nga hyrja në forcat e punës dhe për të shkëputur fëmijët që punojnë nga punët shfrytëzuese dhe të rrezikshme.

- Ngritja e ndërgjegjësimit mbi problemet e punës së fëmijëve në nivel kombëtar, në komunitet dhe në vendin e punës.

- Mbrojtja e fëmijëve që punojnë, riaftësimi dhe integrimi i tyre në sistemin arsimor.

- Mëshkëmbja e trajnimit profesional dhe arsimimit jo formal për fëmijët që punojnë.

- Mëshkëmbja e hartimit dhe zbatimit të një legjislacioni mbrojtës, si edhe zbatimi i legjislacionit ekzistues.

Bazuar në objektivat strategjike të sipërpërmendura, programet kryesore të zhvillimit përqendrohen në:

- Ngritje kapacitetesh

- o Ngritja e kapaciteteve të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për luftën kundër punës së fëmijëve. IPEC ka ndihmuar për krijimin e mekanizmave institucionale mbi çështjet e punës së fëmijëve, si: Komiteti Kombëtar Drejtues dhe Njësia e Punës së Fëmijëve në Ministrinë e Punës dhe Shanceve të Barabarta.

- o Krijimi i kapaciteteve për 100 inspektorë të punës mbi monitorimin e

punës së fëmijëve.

- o Ndriftja e kapaciteteve të punonjësve të arsimit, në luftën kundër punës së fëmijëve, realizuar nëpërmjet aktiviteteve me Institutin e Studimeve Pedagogjike, duke u përqendruar në trajnimin e 30 përfaqësuesve kryesorë nga Ministria e Arsimit, Instituti i Studimeve Pedagogjike dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale, të cilët do të përdoren si tranues për 80 drejtorë shkollash dhe mësues në pesë qytete - Tirana, Korça, Elbasani, Shkoder, Vlora.

- Përfshirja e punës së fëmijëve në zhvillimin e politikave

- o IPEC synon të përfshijë çështjet e punës së fëmijëve në axhendën e zhvillimeve kombëtare. Strategjitë e reja afatmesme mbi arsimin (tetor 2003) dhe mbi Shërbimet Sociale (mars 2005) në Shqipëri e kanë përfshirë çështjen e punës së fëmijëve, si një pjesë përbërëse të tyre. IPEC ka marrë pjesë aktivisht, duke ofruar ekspertizën e saj në grupet e punës në të dy strategjitë dhe kjo çështje është ndër prioritaret në axhendën politike.

- o Kuadri i Zhvillimit të Ndihmës së Kombeve të Bashkuara (UNDAF) është njëmjet tjetër, nëpërmjet të cilit IPEC dhe partnerët e tij synojnë të sigurojnë që puna e fëmijëve të jetë patjetër në axhendën e zhvillimit.

- Punë kërkimore dhe studimore

- o Vëzhgimi i Vlerësimit të Spejhtë mbi fëmijët që punojnë në qytetet e Tiranës, Vlorës dhe Shkodrës, realizuar nëpërmjet Institutit të Studimeve Bashkëkohore, jep një pasqyrë të shtrirjes dhe pëmasave të problemit dhe siguron një informacion të hollësishëm mbi aspekte të ndryshme të fëmijëve që punojnë në rruzë në qytetet e mësipërme.

- o Kryerja e Vëzhgimit mbi Vlerësimin e Spejhtë të trafikimit të fëmijëve në Shqipëri, sidomos për shfrytëzim për punë ose për prostitucion, si pjesë e një Programi Prandalimi dhe Ri-integrimit për të luftuar trafikimin e fëmijëve në vendet e Ballkanit dhe Ukrainë.

- o Harmonizimi i legjislacionit kombëtar mbi çështjen e punës së fëmijëve me standardet ndërkombëtare

- Mëshkëmbja e drejtpërdrejtë në dhënien e shërbimeve

- o Mëshkëmbja e drejtpërdrejtë për

fëmijët që punojnë, realizuar nëpërmjet OJQ-ve shqiptare. Në ambientet e disa shkollave 9-vjeçare në Tiranë, Shkodër, Korçe, Berat, Elbasan janë ngritur klubet e fëmijëve për fëmijët që punojnë, kanë qenë trafikuar dhe fëmijët në rrezik të trafikimit, duke organizuar aktivitete shplohëse, shpërndarë tekste mësimore për nxënës të klasave të arsimit të detyrueshëm, siguruar trajnime profesionale bazë për punime artizanati, mbrojtje etj.

- o Sigurimi i kursve trajnuese profesionale për fëmijët që kanë qenë kontigjent trafikimi ose për ata në rrezik për t'u trafikuar dhe punësimi i tyre në tregun e punës. Kjo realizohet me mbështetjen e Qendrave Rajonale Profesionale Trajnuese.

- Bashkëpunimi me partnerët sociale dhe aktivitete ndërgjegjëzuese

- o Bashkëpunimi me partnerët socialë, me organizatat e punëtorëve e punëdhënësve, me synim që të ngrihen njohuritë, kuptimi, aftësitë teknike të tyre mbi punën e fëmijëve dhe mbi masat konkrete që duhet të merren, duke trajnuar gjatë vitit 2002-2004 mbi 80 përfaqësues nga sindikatat e arsimit dhe 20 përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve.

- o Zhvillimi i aktiviteteve me rastin e Ditës Botërore kundër Punës së Fëmijëve ka qenë një nga aktivitetet kryesore për ndërgjegjësimin e opinionit publik, së bashku me botimin e një sërë librave, fletushkave, si edhe me realizimin e një dokumentari mbi punën e fëmijëve në Shqipëri

Drejt së ardhmes

Objektivi afatgjatë i ILO-IPEC në Shqipëri është eliminimi progresiv i punës së fëmijëve, nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të punës. Hartimi i politikave sociale, ndërgjegjësimi i opinionit publik, ngritja e nëtejsme e kapaciteteve dhe zbatimi i programeve gjithpërfshirëse janë disa nga fushat ku do të përqendrohet puna e ILO-IPEC.

Mbi të gjitha, ILO- IPEC synon zbatimin e një programi mbarekombëtar, me afate dhe dobjektiva të përcaktuara, si në nivel qendror dhe atë vendor drejt eliminimit të punës së fëmijëve.

Metoda SCREAM në seminarët me drejtuesit e sindikatave të arsimit në rrethë

Me synimin për të rritur aftësitë e mësuesve për të përfshirë vetë fëmijët në ribrojjen e të drejtave të tyre, përfshirë të drejtën për të mos u angazhuar në punë dhe për të mos u shfrytëzuar seksualisht, një metodë interaktive dhe përfshirëse e të gjithë pjesëmarrësve në

metoda SCREAM, (Mbështetjet e të Drejtave të Fëmijëve Nëpërmjet Arsimimit, Artit dhe Medias).

Në keto seminare janë paraqitur të gjitha modulet e përgatitura për të përfshirë fëmijët dhe të rinjtë në fushatën globale për të eliminuar punën e fëmijëve dhe të bazuar në

madh mund të pasqyrojë këtë problem kaq të madh si puna e fëmijëve.

Moduli i Imazhit - U trajtua me synimin për të krijuar profilet e fëmijëve që punojnë, mbi bazën e disa imazheve. Në seminar u paraqitën dhe u komentuan një numër i konsiderueshëm fotografish nga Foto-CD, si edhe nga realiteti shiptar e ai botëror. Pjesëmarrësit dhanë mendime në lidhje me temën dhe paraqitën çështjen se si kanë ndodhur ndryshimet në shoqëri.

Moduli i Luajtjes në Role - Pjesëmarrësit luajtën rolin e fëmijëve që punojnë dhe të njerëzve që bashkëveprojnë me ta, (prindërit, punëdhënësit, zyrtarët), nëpërmjet aktiviteteve mbi: imazhet e pandryshueshme dhe luajtjen e rolit.

Moduli i Dramës - Stimulon shprehje dramatike dhe siguron një rrugëdalje nëpërmjet së cilës të rinjtë mund të shprehin vetveten në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Ai krijon një platformë të fuqishme për edukimin e komunitetit dhe

ngritjen e ndërgjegjësimit.

Moduli i Konkurrencës në Art - Stimulon shprehjen artistike, përmirësimin e edukimit të komunitetit dhe ngritjen e ndërgjegjësimit. Ky modul u trajtua i lidhur ngushtë me Modulin e Integritetit të Komunitetit, si pjesë e procesit të integritetit të komunitetit (sponsoret, bizneset etj.).

Moduli i të Shkruarit Krijues - Pjesëmarrësit iu paraqitën teknikat se si mund të krijohet një histori me një temë të thjeshtë të bazuar në aktivitetin e metodës me 4 quadrate. Ajo stimulon të shprehurit letrar dhe krijon mundësinë e të shprehurit të ndjenjave të brendshme mbi punën e fëmijëve, (aftësi letrare dhe komunikuese).

Bota e Punës - U prezantua për të theksuar dhe mbështetur ndikimin e mardhënieve trepalëshe në zhvillimin social, rolet e ndryshme të komunitetit dhe se si këto organizata mund të bashkëveprojnë për të mirën e shoqërisë.



Meraxherja Kombetare e ILO-IPEC në Shqipëri, zonja Snezhi Bedalli në njerzën nga seminarët me perfaqësues të sindikatave të arsimit.

diskutime u zbatua në seminarët që janë organizuar në rrethet Fier, Elbasan, Korçë, Berat, me pjesëmarrjen e drejtuesve sindikalistë të arsimit nga të dy sindikatat e këtij sektori, FSASH e SPASH, ku është zëbërthyer e diskutuar

përdorimin e artit, (pikturës, letërsisë e teatrit), dhe të Medias, (metodat e organizimit të fushatave dhe të rrjeteve).

Moduli i Kolazhit - Stimulon shprehjen pamore dhe artistike dhe evidenton se si media me tirazh jo shumë të

Veprime konkrete dhe bashkepunim i gjere per eliminimin e punes se femijeve Nga Seminari i zhvilluar ne rrethin e Elbasanit

Vijon nga faqja 8

sidomos per terheqjen e femijeve qe punojne ne shkolle ose per organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve te tjera ne ata femije qe e kane te pamundur te rikthehen ne shkolle.

Diskutimet rreth kesaj teme nga ana e pjesemarresve ishin nje baze e mire per perpunimin e planit te veprimeve per te ardhmen. E pajustificuar ishte mungesa ne kete seance e perfaqesuesve te Drejtorise Arsimore Rajonale, te cilet treguan pargjegjshmeri per nje qeshtje qe eshte drejtpdrejt e lidhur me punen e tyre.

Dy seancat e dites se trete ishin, gjithashtu, interesante dhe efektive. Ne seancen e pare ekspertet holandeze paraqiten pervojën e AOB ne punen me nxenesit me probleme dhe angazhimin e mësuesve per parandalimin e punes se femijeve, duke theksuar se ky problem nuk eshte i pranishem vetem ne Shqiperi, por kudo, edhe ne Holande, ku gjendet sidomos ne poqeri, ne bujqesi dhe ne miniera. Zoti Marten Kirch theksoi, gjithashtu, se ky problem eshte ekonomik, qe lidhet me varferine, por ne te njejten kthe ai eshte po aq, ne mos

me shume edhe qeshtje mentaliteti, prandaj puna e sindikatave duhet te perqendrohet ne te dyja keto aspekte. Me tej, ai vleresoi angazhimin e mësuesve te rrethit te Elbasanit, ne lidhje me kete qeshtje, pavaresisht nga ngarkesa e madhe qe kane ne procesin mesimor dhe pagat e ulta, duke u ndalur edhe ne shpjegimin e konceptit holandez mbi femijerine, si nje qeshtje qe nuk duhet te kufizohet vetem tek te mesuarit ne shkolle, por edhe tek plotesimi i kerkesave te shunta qe lidhen me interesat e femijeve ne kushtet e kohes kur jetojne. Ai theksoi rolin e rendesishem te sindikatave te arsimit, te cilat duhet te mos priren nga projekte te medha, por te fillojne te punojne me programe te vogla ne disa shkolle pilot, duke organizuar aktivitete zbatimore e terheqese jo shume te kushtueshme me synimin e zgjerimit te tyre ne te ardhmen.

Ne seancen e fundit te gjithë pjesëmarrësit ne seminar raportuan mbi gjendjen ne shkollet perkatese dhe bene propozime per planin e veprimit, ne kuadrin e te cilit u peraktuan disa nga drejtimet kryesore te punes per te ardhmen. Duke bere konkluzionet e kesaj se-

ance, dhe te seminarit ne teresi, zoti Xhafer Dobushi e vuri theksin tek disa nga detyrat e nguteshme e konkrete te te dy seksioneve sindikale ne shkollë rrethi dhe te vete sindikatave ne shkollë, sidomos per evidentimin me te mire te gjendjes dhe organizimin e punes konkrete me nxenesit qe kane braktisur shkolle ose qe jane ne mrezik per ta braktisur ate, tek organizimi i nje pune te vecante me nxenesit me probleme, zgjerimi i aktiviteteve edukuese e shlodhese me nje pjesemarrje sa me te gjere te nxenesve, si edhe forcimi i bashkepunimit me Drejtorine Arsimore Rajonale dhe me organet e pushtetit lokal dhe OJF-te per terheqjen me shkolle ose per përfshirjen ne forma te tjera kualifikimi te femijeve qe jane te angazhuar ne pune.

Duke reflektuar per verejtjet e drejta qe u bene nga pjesemarresit ne seminar, z. Dobushi nervizoi angazhimin e dy sindikatave te arsimit ne rastin e diskutimit te projekt-buxhetit te vitit 2006, me qellim qe te miratohen edhe disa fonde per paisjen e shkolleve me disa vegla muzikore ose sportive, qe sot mungojne.

Pse puna e femijeve eshte nje çeshtje sindikale?

1. Puna e femijeve favorizon sektorin informal
2. Puna e femijeve minon forcën negociuese
3. Puna e femijeve kontribuon ne papunesine e te rriturve
4. Puna e femijeve eshte rrjedhoje e varfersie, por ajo eshte edhe nje ndër shkaqet e varferise
5. Puna e femijeve t'errheq vemendjen sindikale per faktin se bazat e sindikalizmit jane solidariteti dhe drejtesia

Tribuna sindikale

